

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. $\frac{5987}{2}$ Prot

Fier më, <u>29</u> /<u>05</u> /2025

PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 29.05.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 13:00. Të pranishëm në mbledhje 41 këshilltarë.

Znj.Fatbardha Merkaj

Përshëndetje të gjithëve ! Fillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak, meqënëse kuorumi është arritur.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës.

Znj.Fatbardha Merkaj

Materialet besoj se ju kanë ardhur të gjithëvë në mënyrë elektronike. Kështu që hedhim ne votim rendin e ditës pa shtesat. Më pas do të miratojmë edhe shtesat. Kush është dakort ?

Pro 41

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Z.Armando Subashi

Atëherë veç pikave të rendit të ditës që ishin parashikuar, unë kërkoj që të bëjmë disa shtesa, për të cilat materialet janë bërë gati dhe u janë shpërndarë këshilltarëvë. Pikat shtesë janë :

1-"Për dhënie ndihmë financiare për shtetasin Ervin Tare, Lagjja "Konferenca e Pezës", për dëmet e pësuara nga plasja e bombulës së gazit."

2-"Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha që kërkojnë të përfitojnë nga subvencioni i qirasë në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura për të përballuar vlerën e qirasë"

3-"Për shtyrjen e afatit të pagesës të taksave vendore për subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetin në territorin e bashkisë Fier."

4-"Për përcaktimin e nivelit të pagave të vrojtuesve të plazhit"

5-"Për fillimin e procedurave gjyqësore për detyrimin që shoqëria U.K. e cila ka qenë në rolin e agjentit tatimor, i ka bashkisë Fier."

Këto janë në mënyrë të përmbledhur dhe kur të vijë momenti do të bëjmë dhë shpjegimet dhe relatimet përkatëse.



Znj Fatbardha Merkaj

Miratojmë dhe pikat shtesë të rendit të ditës ? Kush është pro ?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Të gjithë pro, miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.04.2025

Znj.Fatbardha Merkaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.04.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dakort ?

Z. Arnando Çupa

Procesverbali ju është nisur të gjithë kryetarëve të grupeve me email dhe është firmosur prej tyre. Faleminderit !

Znj.Fatbardha Merkaj

Kush është dakort ?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Të gjithë pro, miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, per muajin prill 2025."

Znj.Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga administrata ?

Znj.Suela Prifti

Përshëndetje! Për muajin prill janë 48 familje që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar prej 6%. Katër prej të cilavë dalin nga skema për t'ju nënshtruar verifikimit dhe futen gjashtë familje të reja. Gjëndja e tyre ekonomike nuk është e mirë dhe për këtë arsye propozohen të futen në skemën e 6%-shit. Vlera totale e fondit 6% për këtë muaj është 226,528 (dyqind e njezetegjashte mije e peseqind e njëzet e tetë) lekë.

Z.Elvi Daka

 \wedge

Përshëndetje të gjithëvë ! Ditën e martë, datë 26.05.2025 u mblodh edhe komisioni përkatës për të vlerësuar rë gjithë dokumentacionin e paraqitur për ndihmën ekonomike. Gjashtë janë rastet e ardhura, ndër të cilat

pesë janë gra kryefamiljare dhe një është burrë kryefamiljar. Raportet sociale ka qenë të përcaktuara qartë, ku ishte një vlerësim i duhur socialo-ekonomik dhe ne si komision kemi vendosur futjen e të gjashtë familjeve në skemë me dakortësinë ë të gjithë anëtarëve të komisionit. Faleminderit !

Znj.Fatbardha Merkaj

E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Të gjithë pro, miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për miratimin e Pasqyrave Financiare të SH.A Klubit Shumësportësh "Apollonia" për vitin 2024"

Znj. Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga administrata ?

Znj. Eleni Gjikondaj

Klubi shumësportësh "Apollonia" ka paraqitur pasqyrat financiare për vitin 2024, ato i ka rakorduar me thesarin dhe gjithashtu ka edhe detyrimin ligjor për t'ja paraqitur këshillit për miratim. Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024 janë si më poshtë : të ardhurat nga shitjet në vlerën 670 000 lekë, nga sponsorizimet 300 000 lekë, sponsorizime nga bashkia, (aksioneri) 36 512 500 lekë. Shpenzimet nga materialet e konsumuara 2 391 765 lekë, kosto e punës 18 395 173 lekë, pagesat e personelit 15 762 677 lekë, shpenzime nga sigurimet 2 632 496 lekë, amortizimi 8 173 640 lekë, shpenzime të tjera 15 917 309 lekë. Totali I shpenzimeve është ne vlerën 4 877 887 lekë, ndërsa të ardhurat e tjera janë në vlerën 2 737 873 lekë. Fitimi dhe humbja bruto janë në vlerën 4 657 514 lekë. Kjo është në vija të përgjithshme pasqyra financiare e klubit shumësportësh Apollonia për vitin 2024. Më të detajuar e keni të pasqyruar në materialet e paraqitura dhe të dërguara nga sekretari i këshillit gjithë secilit prej jush elektronikisht. Nëse keni pyetje jam e hapur për tu përgjigjur. Faleminderit !

Z. Kreshnik Dapi

Me leje. Kam tre pyetje. Sa kohë ka që klubi del me humbje, sa vite ? Cilat janë arsyet që klubi del me këtë nivel humbjesh dhe si e parashikoni ju të ardhmen në rast se kjo situatë do të vazhdojë ? Faleminderit !

Z. Eleni Gjikondaj

Kjo situatë vjen më shumë nga amortizimi. Duke qenë se ndërtesat që klubi përdor janë shumë të vjetra. Humbja nuk vjen si pasojë se klubi ka më shumë shpenzime sesa të ardhura, pasi ato janë aty aty.

n

Z. Armando Subashi

R

Çfarë fusni në të ardhurat ju, ato lekë që japim ne si bashki ?

Z.Eleni Gjikondaj

Jo vetëm ato por edhe sponsorizimet e tjera. Kurse tek shpenzimet sikurse e thashë kryesisht janë amortizimet e ndërtesave dhe të gjithë makinerive dhe pajisjeve që klubi ka në inventar dhe që te gjitha aktivet e tjera. Duke qenë se amortizimet janë në vlerën 8 milion klubi ka humbje. Pra duhet të marri më shumë lekë nga bashkia.

Z.Kreshnik Dapi

Sa vite ka klubi me ketë situatë ?

Znj.Eleni Gjikondaj

Në tre vitet që kam unë, kjo situatë ka qenë.

Z.Kreshnik Dapi

Me këtë vlerë humbjeje 4.6 milionë?

Znj. Eleni Gjikondaj

Jo. Rreth 4 milionë pasi sikurse e thashë të ardhurat dhe shpenzimet e klubit janë aty aty, por koston e rrit amortizimi i ndërtesave dhe i pajisjeve që klubi ka në inventar dhe që ai përdor.

Z. Kreshnik Dapi

Kjo është një vlerë e konsiderueshme dhe mund të përdoret për të bërë investime të tjera.

Znj. Eleni Gjikondaj

Atëherë për të ulur humbjet ose duhet të nxjerrin jashtë përdorimit ndërtesat dhe mjetet e amortizuara ose duhet të rritet fondi që klubi merr nga bashkia.

Z. Kreshnik Dapi

Si e parashikoni dhe si mund të zgjidhet kjo situatë ?

Znj. Eleni Gjikondaj

Këto që thashë më lart janë zgjidhjet, të tjera s'ka.

Z. Ilia Fili

Në vazhdim të diskutimit që bëri kolegu, unë pyes. Humbja prej 4 milion e ca, natyrisht për një ekip të nivelit të Apollonisë nuk është e vogël. Kjo humbje vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga burimet e parashikuara në projekt, apo janë tejkaluar shpenzimet e prashikuara dhe të miratuara nga ne këtu në këshill ? Se në qoftë se janë tejkaluar shpenzimet nga parashikimi është tjetër gjë dhe është tjetër gjë nëse nuk janë siguruar të ardhurat nga burimet e parashikuara.

Znj. Eleni Gjikondaj

Sikurse e thashë klubi ose duhet të rrisi të ardhurat duke siguruar sponsorizime të tjera ose duhet të rrisim ne si bashki fondin që duhet të japim për të. Nuk është se ata rrisin shpenzimet, por është pjesa e amortizimit, i cili rritet vit pas viti, që rrit humbjet e tyre si klub.

Z. Ilia Fili

Më fal, ne si bashki kuotën që duhet ti japim klubit e kemi realizuar apo nuk e kemi plotësuar ?

Znj. Eleni Gjikondaj

Në fakt nuk e kemi dhënë të gjithë vlerën,

Z. Ilia Fili

Pra kjo humbje vjen nga burimi i të ardhurave jo nga shpenzimet ?

Znj. Eleni Gjikondaj

Po.

Z.Ilia Fili

Jeni e sigurt ?

Znj. Eleni Gjikondaj

Jua thashë se shpenzimet nuk janë më të larta se të ardhurat.

10

Z. Ilia Fili

Më falni. Unë e lexova me shumë vëmendje materialin, por nuk gjeja dot shpjegimin e humbjeve. Nëse ne miratojmë këtu këtë analizë financiare, të një klubi që kryesisht financohet nga bashka, pasi bashkia e mban gjallë, dhe burimet e tjera janë të vogla mesa pashë në material, duhet të shpjegohet arsyeja. O do mbajmë ne si bashki përgjegjësi që fondin e parashikuar nuk e kemi dhënë, ose do të dali përgjegjësia përse është krijuar kjo humbje ? Sepse edhe një vit më parë kjo histori ishte. E njëjta histori edhe këtë vit. Historitë që përsëriten sikur nuk bien erë të mirë.

Z. Armando Subashi

Së pari se mos ka ndonjë keqkuptim, nuk bëhet fjalë për klubin e futbollit, bëhët fjalë për këtë që është 100% me aksioner bashkinë, ku drejtor është Paljoni të cilin e kemi këtu. Pra disa vitesh, më duket para tre katër vitesh, në bazë edhe të ndryshimit që pësoi ligji, të gjitha ato ekipe që realisht mbaheshin nga bashkitë, basketboll, volejboll, bile shumë kishin edhe futbollin. Kurse ne ishim nga ato bashki që e kishim të ndarë, pasi ka vite që është krijuar ajo sh.a-ja, ku bashkia ka pjesën e vetë të aksioneve kurse privati ka pjesën e tij. Kurse gjithë sportet e tjera kishin mbetur jetim dhe mbaheshin si dhe sa mundeshin nga bashkitë. E njëjta gjë edhe tek ne. Ndryshoi ligji dhe u gjykua që të krijoheshin në formën e sha-ve edhe ato, ku bashkitë kanë 100% të aksioneve. Tani mbi këtë bazë, në thelb, i gjithë ai burim të ardhurash që shkon për këtë sha është pjesë që e japim ne, pra lekë të bashkisë janë ato. Janë lekë që miratohen këtu në këshill dhe i shkojnë kësaj sha-je. Dhe këto besoj duhet të përbëjnë në masën dërmuese burimin e të ardhurave të sha-së dhe mbi bazën e kësaj ajo duhet të përbëjnë në masën dërmuese burimin e të ardhurave të sha-së dhe mbi bazën e kësaj ajo duhet të përbashkët, pse jo edhe me pjesëmarrjen e disa këshilltarëve si dhe me pjesëmarrjen e ekzekutivit të bashkisë, ta rishikojmë atë strukturë. Sa punonjës ka aty Palion ?

Z.Paljon Zarka

N

Vetëm punonjës janë 23.

V

Z. Armando Subashi

Pra 23 punonjës që marrin pagën. Ndofta ne mund të ngremë një grup, ta shikojmë nëse janë të gjithë të domosdoshëm, mund të bëjmë ndonjë reduktim apo ndonjë ndryshim në strukturën e sha-së. Sepse kjo është njëra pjesë e shpenzimeve, pra pagat dhe sigurimet. Plus pastaj, pjesa tjetër është mbajtja me atë buxhet që ne i japim të atyre ekipeve që janë atje si basketbolli, volejbolli apo edhe sportet e rënda. Të gjitha këto kanë ato shpenzimet e veta për pagat dhe sigurimet si edhe për pjesëmarrjet në kompeticione. Kjo histori për sa kohë që nuk pesona apo subjekte private, të cilat mund të shfaqun interes për të blerë një pjesë të aksioneve pasi të gjitha do të ishte e vështirë, dhe në këtë mënyrë të jenë kontributorë në buxhetin e kësaj sha-je, besoj që kjo kështu do të vazhdojë. Pra në thelb, pavarsisht se në termat financiarë që financierët i quajnë të ardhura shpenzime, fitim apo humbje, ai është i gjithë buxheti jonë, pra janë lekët e bashkisë që i japim asaj sha-je. Sha-ja realizon shumë pak të ardhuara, ndoshta nga sponsorizimet, nga biletat kryesisht që kanë qenë për ndëshjet e basketbollit të djemve, që u bë viti i dytë që e kemi ngritur në një nivel të caktur. Ishim në 6-en më të mirë në superligë, dolëm në vendin e tretë, dhe që padyshim që puna duhet të vazhdojë edhe për sportet e tjera, si për volejbollin, basketball vajza, për moshat e kështu me rradhë. Ajo që mendojë unë është që së pari ne të bëimë një studim si mund të reduktojmë shpenzimet, duke filluar nga struktura. Të shohim nëse të gjithë që janë aty janë të nevojshëm apo mund të bëjmë ndonjë ndryshim. Nëse mund të shtojmë pjesën e trajningut, pra të trajnerëve, pasi sot një pjesë e trajnerëve paguhen një pjesë jo. Pra duhet ta shikojmë këtë gjithmonë me idenë e masivizimit që të prekim sa më shumë grupmosha dhe lloje sportesh. Dhe ndoshta duhet ti vëmë një objektiv drejtuesit të sha-së që ai të shkojë çdo ditë nëpër biznese për të kërkuar sponsorizime. Sepse ne kemi një përvojë të mirë aty ku disa biznese kundrejt një reklame që e kanë vendosur tek pallati i sportit, ku reklamojnë emrin e firmës apo kompanisë së tyre, kanë sponsorizuar diçka, kush dy milion lekë të vjetra, kush tre milion, kush sjellë ujin për sportistët, dikush bluzat e ekipeve etj. Pra Fieri është një bashki që ka biznese nuk është se nuk ka dhe ndoshta me një politikë të caktuar duke i hapur hapsirën për reklamim të biznesit, të shihet mundësia për të mbledhur diçka më shumë nga pjesa e biznesit për sa i takon sponsorizimit. Pastaj ato humbjet në kontabilitet që çdo objekt vit pas viti amortizohet dhe humbet vlerën me 1 % apo me 2 %, ato do të vazhdojnë të jenë. Pra ne akordojmë një buxhet vjetor, sa është saktësisht ky buxhet Paljon?

Z.Paljon Zarka

270 000 milionë lekë të vjetra.

Z.Armando Subashi

Pra kjo është ndoshta gjëja që duhet parë dhe të ndryshojë pak se sigurisht sado që të lodhemi ne për këtë pjesën e sponsorizimit nuk është se do të ndodhi ndonjë çudi, por të krijohet një lloj tradite dhe të shtohet kjo pjesa e sponsorizimit. Dhe ndoshta mund të jetë momenti të tentojmë të nxjerrim në shitje një pjesë të aksioneve të sha-së , nëse ka interes të vijë dhe të afrohet dikush dhe më pas mund të ketë edhe aksioneri ndonjë ide për të zhvilluar basketbollin, volejbollin e tjera me rradhë pasi këto janë sportet që kanë ngelur tek sha-ja dhe që janë më popullore le të themi. Tek basketbolli dhe tek volejbolli Fieri ka pasur traditë dhe ne po mundohemi ti mbajmë ato. Edhe tek volejbolli, tek të rejat, kemi një ekip shumë të mirë, dolëm nënkampion në mos gabojë këtë vit. Edhe me të rinjtë e basketbollit jemi në nivele shumë të mira. Është një punë që duhet ngritur më tej edhe me investimet tek pallati i sportit, të cilin e gjetëm si e gjetëm dhe e kemi çuar atje ku është sot. Besoj kushtet sot janë shumë të mira dhe të gjithë që kanë ardhur i kanë vlerësuar, qoftë pajisjet, qoftë parketin, të cilat janë nga më të mirat në Shqipëri. Mund të vazhdojmë të investojmë tek ato tre fushat e sportit që janë ngjitur atje, për të përmisuar kushtet edhe për më të vegjlit. Ka një masivizim

10

 \cap

për të thënë të vërtetën dhe kjo është positive, por mendoj që duhet të ecim në këtë drejtim. Do të fillojmë javës që vjen besoj me rehabilitimin e shumë terreneve nëpër shkolla, me tapete me të gjitha, dhe besoj që edhe këto ekipet e moshave, pasi kemi edhe shumë trajnerë sikurse edhe zysha që është këtu, të cilët do ta kenë të hapur për ta shfrytëzuar edhe këtë pjesën e terreneve sportive nëpër shkolla. Edhe rehabilitimi i palestrave do ti japi një shtrirje më të madhe këtij masiviteti. Dhe prej aty mund të burojnë një pjesë e mirë e sportistëve që do të përfaqësojnë Apolloninë në të gjitha nivelet dhe disiplinat sportive.

Z. Kreshnik Dapi

Mund të bëjë dhe një pyetje kryetar, për kuriozitetin tim. Unë e zotin Paljon e njoh si qytetar fierak dhe nuk dua të ketë keqkuptime, ju dëgjova edhe ju me të gjitha shpjegimet që dhatë. Por duke ardhur nga fusha e biznesit, biznesi ka disa rregulla dhe shoqëria në fjalë është sha, pavarsisht se sponsorizohet nga bashkia dhe është ajo pronare. Keni provuar ta ndryshoni strukturën drejtuese të klubit, ose më saktë zoti Paljon sa kohë ka në atë detyrë ? Sepse ka një rregull kur një kompani del me humbje një vit dhe vitin tjetër ajo thellohet e kështu me rradhë, mbase problemi është edhe tek njerëzit që drejtojnë ?

Z. Armamndo Subashi

Gjithë ajo që thashë unë pak më sipër nuk është se ka lidhje me mirë apo keq administrimin e sha-së. Pra këtu nuk është çështja që Paljoni e ka administruar keq dhe hajde të gjejmë dikë që ta administrojmë më mirë. Edhe biznesmenin më të suksesshëm të vëmë ne, që ka bërë suksesin më të madh në biznes, në ato kushte që unë e shpjegova se si funksionon ajo sha, në të njëjtat shifra apo rezultate do të arrinim. Shpenzimet bazë të saj janë mbajtja në këmbë e ekipeve, sepse edhe ai ekip basketbolli që thashë unë më sipër, qoftë fierak qoftë të huaj duan disa paga, sepse ata nuk vijnë pa lekë, të luajnë për Apolloninë. Po pjesëmarrja në kompeticione që ka edhe ajo shpenzimet e veta ? Djemtë e superligës shkonin në Shkodrër në Tiranë, ku ishin ndeshjet e superligës, volejbolli po ashtu, udhëtimi, dieta, fjetje, ngrënie etj. Dhe ne e dimë shumë mirë që të mbash sot një ekip nuk ëshrë gjë e vogël. Dhe ne në fakt, kur kemi kemi diskutuar para pak kohësh, që një pjesë prej jush ishte edhe kundër, kur thamë që do të shfrytëzojmë asetet e bashisë tek Ekomarketi, dhe realisht ne kemi investuar atje dhe kemi krijuar një mini hotel, kemi krijuar 5 dhoma dhe një guzhinë dhe shumë shpejt, pasi fjetja është vënë në fuksionim, do të vihet në funksion edhe kjo e fundit. Dhe kemi kursyer goxha lekë, sepse ti mbash në një hotel 5, 6, apo 7 sportistë jo fierak, natyrisht kushton shumë më shumë sesa ti akomodosh në një tëndin të bashkisë, në të cilin ti ke shpenzuar disa lekë për arredimin e tij dhe kaq. Dhe tani ata flenë pa shpenzime të tjera. Ndërkohë sikurse e thashë kemi synimin që të kompletojmë edhe një mini guzhinë, në mënyrë që ata të ushqehen atje duke punësuar atje një guzhiniere dhe një ndihmëse dhe duke evituar kështu shpenzime ekstra nëse ata do të usheheshin jashtë. Sepse tjetër gjë është të hashë jashtë 3 vakte dhe tjetër gjë është të ushqehesh atje, ku do të blesh vetëm ushqimet. Ndërsa për Paljonin për përkushtimin që ke pasur, ke vlerësimin tim maksimal. Në përfundim mund të them që për sa kohë nuk ka një ligj që të nxisë sponsorizimin e sportit në Shqipëri, bashkitë bëjnë sakrifica të mëdha për ti mbajtur këto shoqëri. Ne mund ta zgjidhim dhe ndryshe, e bëjmë buxhetin zero dhë nuk merremi as me futbollin as me basketbollin as me volejbollin etj. Dhe i kursyem ato x million lekë që shpenzon sha-ja, mbajmë vetëm dy vetë atje sa për të thënë që funksionon dhe kaq, por na vlenë në mospërfaqësimin e ekipit në kompeticionet kombëtare, të mos kemi asnjë ekip në asnjë sport ? Pra realisht unë jam i hapur që sikurse e thashë më lart edhe mbledhjen tjetër të ngremë një grup pune edhe nga këshilli edhe nga administrata dhe të shikojmë rrugët dhe mundësitë sesi mund të reduktojmë një pjesë të shpenzimeve dhe sesi të shikojmë mundësitë pastaj nëpërmjet burimeve të tjera jashtë bashkisë të shtojmë sado pak të ardhuat tek sha-ja.

~

10

Znj Fatbardha Merkaj

E hedhim për miratim ?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e pestë e rendit të ditës

Projekvendim "Për miratimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin 2024 të Bashkise Fier"

Z. Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga administrata ?

Znj. Pranvera Cina

Hartimi i pasqyrave financiare për bashkinë Fier si dhe për ndërmarrjet vartëse si dhe për sha-t, një pjesë e të cilave janë në varësi të bashkisë, është bërë në mbështetje të ligjit për financat dhë udhëzimin e ministrisë së financave për pregatitjen, raportimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Si dhe udhëzimin plotësues të vitit 2023 për procedurën e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023. Pasqyrat financiare u hartuan në të gjitha formatet që pasqyrojnë të dhënat e buxhetit të planifikuar, të ndryshuar gjatë vitit dhe shpenzimet e kryera sipas zërave duke pasqyruar edhe transferimet për insitucionet vartëse në përputhje me kërkesat ligjore. Bashkia Fier ka nën juridiksionin e saj 7 institucione varëse ,si dhe UKF, si dhe klubin shumësportësh "Apollonia" Fier dhe klubin e futbollit "Apollonia" Fier. Në hartimin e pasqyrave financiare të kosoliduara jemi bazuar në printimet e pasqyrave elektronike të dorëzuar në degën e thesarit Fier si dhe janë bërë rakordimet përkatëse të cilat janë dërguar në ministrinë e financave. Nëse keni diçka për të pyetur jeni të lirë ta bëni. Faleminderit !

Z. Ilia Fili

Më falni. Ky vjen për informacion tek ne apo për ta miratuar ?

Znj. Pranvera Cina

Pas rakordimit që kemi bërë më degën e thesarit këto pasqyra është detyrim ligjor të miratohen në këshill.

Znj. Fatbardha Merkaj

E hedhim për miratim. Kush është pro?

Pro 40 vota

Kundra s'ka

Abstenim 1 votë

Vetëm një abstenim, miratohet.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

10

Projekvendim "Për miratimin e implementimit të projektit strategjik me titull ''CIRCLE'' në kuadër të instrumentit të para anëtarësimit, IPA III, programi i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2021-2027" si dhe implementimi i projektit "BLUENEË" në kuadër të instrumentit të para anëtarësimit INTERREG IPA ADRION 2021-2027"

Znj. Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga administrata ?

Znj. Eleni Gjikondaj

Bashkia Fier ka përfituar dy projekte në bashkëpunim me Koordinimin e programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor, dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin strategjik me titull "CIRCLE", në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi–Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-dhe "BLUENEW" ne kuader te INTERREG IPA ADRION 2021-2027

Mbështetja dhe drejtimi i strukturave administrative të Bashkisë për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian si dhe informimi i qartë për Thirrjet për Aplikime të shpallura në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Territorial të Bashkimit Evropian. Bashkërendimi dhe koordinimi me strukturat e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak për përfshirjen e të gjitha projekteve të financuara nga donator në buxhetin vjetor si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm, ju paraqesim për miratim dy projektet e mësiperme.

Z. Armando Subashi

Çfarë do të miratojë këshilli këtu ?

Z.Eleni Gjikondaj

Vlerën e plotë të projekteve, pasi është detyrim ligjor për ta patur projektin në buxhet dhe për ta miratuar me VKB, pasi e kërkojnë partnerët. Megjithëse e keni në materialet e paraqitura, unë po e relatojë për të qenë edhe në procesverbalin e mbledhjes. Për sa i takon projektit të parë. buxheti për Bashkinë Fier është 389.591,20 euro nga te cilat: 311.672,96 euro kontribut i BE dhe 77.918,24 euro bashkefinancim i Bashkise Fier. Bazuar në buxhet, Bashkia Fier ka detyrimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së .Thirrja në të cilën bazohet shkrimi i këtij projekti lidhet me ekonominë qarkulluese. Në nivel ministror janë targetuar dy bashki në Republikën e Shqipërisë për të qënë pjesë e aplikimit në këtë thirrje. Pas konsultimit me strukturat drejtuese në bashki, bazuar në nevojat dhe prioritetet e bashkisë, është menduar që fokusi i projektit të jetë menaxhimi efikas i mbetjeve, ndarja dhe riciklimi duke qenë në këtë mënyrë koherent me fushën që mbulon kjo thirrje.

Koncepti i "Parkut të Ekonomisë Qarkulluese" - është një koncept që promovon parimet e një ekonomie qarkulluese brenda një zone specifike gjeografike. Ai synon zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve për nxitjen e ekonomisë qarkulluese në zonën ndërkufitare. Ai është projektuar për të krijuar një sistem të mbyllur ku burimet maksimizohen, mbetjet minimizohen dhe ndikimi i përgjithshëm mjedisor zvogëlohet. Bashkia Fier përballet me një problem të vazhdueshëm të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve drusore që krijohen nga krasitjet sezonale, pastrimet e hapësirave të gjelbra dhe mirëmbajtja e territorit dhe me mungesën e një sistemi efikas për përpunimin e këtyre mbetjeve. Qëllimi i këtij projekti është



ngritja e një sistemi funksional për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve drusore me qëllim kthimin e tyre në pelet për përdorim energjitik. Projekti parashikon blerjen e një mjeti të specializuar për grumbullimin e lëndës drusore në territorin e Bashkisë Fier. Blerjen e një makinerie përpunuese, e cila do të bëjë shndërrimin e mbetjeve drusore në pelet. Krijimin e një pikë përpunimi dhe prodhimi, e cila do të vendoset në zonën e Azotikut, në një sipërfaqe toke që është në pronësi të Bashkisë Fier dhe e përshtatshme për këtë lloj aktiviteti. Procesi do të përfshijë, grumbullimin e mbetjeve në vend, transportimin në pikën e përpunimit, përpunimin përmes makinerisë së dedikuar dhe prodhimin e peletëve. Peletët do të përdoren për ngrohjen e ambienteve të institucionet publike të bashkisë (shkolla, çerdhe, qendra sociale, etj.) sipas nevojave të identifikuara. Me këtë projekt, mbetjet nuk do të jenë më një barrë mjedisore, por do të përpunohen dhe shfrytëzohen në funksion të interesit publik. Përpunimi i mbetjeve drusore do të shmangë grumbullimin e tyre të pakontrolluar dhe djegiet spontane, duke përmirësuar cilësinë e ajrit dhe sigurinë e territorit. Peletët e prodhuar do të zëvendësojnë karburantet tradicionale të përdorura për ngrohje, duke ulur kostot për energji në institucionet publike dhe duke rritur pavarësinë energjetike. Aktiviteti do të zhvillohet në një pronë të Bashkisë Fier (në zonën e Azotikut), duke e kthyer atë në një qendër përpunimi me vlerë praktike dhe ekonomike. Edhe pse nuk synohet përfitim i drejtpërdrejtë ekonomik, projekti sjell përfitime të konsiderueshme financiare në mënyrë indirekte për Bashkinë Fier përmes eduktimit të shpenzimeve për ngrohje në institucionet publike. Uljes së kostove për menaxhimin dhe transportin e mbetieve drusore. Rritjes së efikasitetit të shërbimeve bashkiake gë lidhen me mjedisin dhe infrastrukturën. Ky projekt përfaqëson një model praktik dhe të qëndrueshëm të ekonomisë qarkulluese, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, optimizimin e burimeve publike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Ndërsa projekti i dytë është në vlerën 99 000 euro, 84 000 euro është financim i BE kurse 14 000 euro është financim i bashkisë që do të mblujë pagat e personelit. Ky ka gëllim forcimin e kapaciteteve për inovacion në rajonin Adriatik-Jonian, me fokus të veçantë në mbështetje të iniciativave për Rritjen Blu (Blue Groëwh). Ai synon ngritjen e një rrjeti transnacional që bashkon aktorë të ndryshëm, përfshirë qendra kërkimore, universitete, agjenci zhvillimi dhe autoritete publike, për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e ujërave në rajon.

Z. Armando Subashi

Shumë mirë. Meqë jemi këtu ne do të fokusohemi në masën 100% tek Gjanica. Pra kur të vijë rradha e kryerjes së ekspertizave përkatëse për ujërat në territorin e bashkisë, i vetmi shqetësim që e kemi pasur dhe që e kemi janë ndodjet që derdhen atje. Jo vetëm tek pjesa e konstatimit, por edhe tek propozimet që mund të na ofrojnë ekspertët për mënyrat e zgjidhjes.

Z. Ilia Fili

Një minutë ju lutem. Të më falin kolegët nëse i bezdisë por më bënë përshtypje një gjë. Në këto që parashtrojë zonja, do të financojë edhe bashkia pjesën e saj apo jo kryetar ? Por më bënë përshtypje që kryetari e mëson këtu në sallë gjithë veprimtarinë tuaj. Ju nuk e konsumoni më parë me kryetarin para se ta sillni në këshill materialin ?

2

V

Z.Armando Subashi

Ka drejtori që funksionojnë të pavarura këtu, hapen thirrjet, konkurojnë, fitojnë.

1 -

Z. Ilia Fili

 \cap

Më vjen keq zoti kryetar por firmën në fund e hidhni ju.

Z. Armando Subashi

Patjetër që po.

Z. Ilia Fili

Ateherë si ka mundësi që të vijë në këshill një material dhe kryetari nuk është në dijeni ? Mua më duket e papranueshme. Mos ma keqkptoni !

Z. Armando Subashi

Një nga drejtoritë që kemi në bashki, ajo për hartimin dhe përpilimin e projekteve në raport me donatorët e huaj, është një drejtori që operon përgjithësisht në mënyrë të pavarur dhe pa marrë leje nga kryetari pasi ajo rri gjithë kohën në vigjilencë dhe shikon, u hap ndonjë thirrje apo jo ? Ku u hap tek BE, tek PNUD apo tek kjo apo ajo ambasadë, pra kudo që mund të hapet ndonjë thirrje, bëjnë aplikimet dhe sigurisht jo të gjitha fitohen. Pastaj atje ku fitohet projekti dhe ku bashkia bëhet pjesë e futet si një partner, bashkë me partner të tjerë të Italisë, Greqisë, Mali të zi etj, sepse përgjithësisht janë projekte në kuadër të vendeve ndërkufitare, diskutohen edhe detajet. Pjesa që duhet të dini është, që në projekte të tilla ata nuk ju kërkojnë partnerëve lokal që ata japin kaq dhe ne duhet të vëmë aq.

Z. Ilia Fili

Kryetar po sikur ju ta kundërshtoni atë financim si kryeta bashkie, duke mos i dhënë këto para, çfarë mund të ndodhë ?

Z. Armando Subashi

Po pse ta kundërshtojë ? Në një rast të tillë unë tërhiqem.

Z.Ilia Fili

Prandaj them unë që këto projekte para se të vinë, këtu duhet të konsultohen me ju.

AN

Z. Armando Subashi

Patjetër që po. Apriori aplikimi për thirrje të tilla nuk vihet në dikutim. Sepse për këtë qëllim e kemi krijuar edhe këtë zyrë, madje ka më mundësi që të fitojmë sa shumë projekte të tilla sepse nuk humbasim gjë, përkundrazi fitojmë. Mund të fitojmë pajisje, ekpertiza, studime, të cilat pastaj i përdorim për përmisimin e shumë gjërave të tjera në qeveri, në njësi përkatëse e kështu me rradhë. Ajo që vlen të theksohet është se ato nuk kërkojnë lekë kesh ose bashkëfinancime me lekë nga partnerët lokalë, por nëpëmjet përfshirjes së specialistëve tanë, pra të bashkisë në fusha të ndryshme sipas drejtorive, të cilët bëhen pjesë e grupeve të punës, ajo konsiderohet si bashkefinancim, sepse në fund të fundit këta specialistë që janë dukë bërë një punë në bashki, kur bëhën edhe pjesë e këtyre projekteve, kosiderohen që marrim pagë edhe për projektin, por pa ndryshuar pagën nga ana jonë, kuptohet. Pra efektivisht në finale fare, ne e kemi zero shpenzimin.

1

Z. Ilia Fili

Ka ndonjë vend bosh në këtë drejtori ?

Z. Armando Subashi

Tek kjo ? Po edhe po nuk ka mund ta hapim. Nëse ju mendoni që mund të ketë kontribute, pse jo. E vërteta është që jo shumë persona mund ta bëjnë atë punë, po nuk je marrë me projekte të tilla, po nuk di të përpilosh apo të aplikosh dhe më pas të implementosh projektë të tilla, nuk e bënë dot atë punë. Nuk mjafton të dijë vetëm gjuhë të huaja, por po qe se nuk është marrë me atë punë, nuk e bënë dot.

Z. Fatbardha Merkaj

E hedhim për miratim. Kush është pro?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e shtatë e rendit të ditës

Projektvendimi "Per miratimin e projektit: Rikonstruksioni i rruges "Kastriot Muço"segmenti (kryqezimi i rrugës "Mujo Ulqinaku" deri tek kryqezimin me unazen "Skenderbej"), (zgjerimi i rrugës si dhe ndërtimi i murit rrethues për objektet që preket nga ky zgjerim.)

Znj. Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga administrata ?

Z. Armando Subashi

Shkurt dy fjalë kam. Ju ndoshta e keni parë pasi ai është segmënti që realisht ka mbetur pa u mbyllur, madje është ngritur edhe ketu në këtë mbledhje në mos gabojë nga këshilltari Gëzim Hajdëraj. Pra bëhët fjalë nga unaza "Skënderbeu" deri tek rruga "Mujo Ulqinaku". Ne e kemi miratuar përpara disa mbledhjesh projektin, jemi duke punuar me ndërmarrjen e bashkisë, janë disa objekte për tu prishur, presim sot apo nesër skualifikimin nga Kadastra të atyre objekteve. Në momentin që vjen skualifikimi do të behët prishja, do hapet dhe do zgjerohet rruga me ato standarte që kemi miratuar. Ajo që ngelej ishte pjesa e disa objekteve aty, përfshirë edhe atë shtëpinë dykatëshe që ka qenë e familjes me mbiemrin që mban edhe rruga, pra Muço, të cilët kanë qenë bazë e luftës. Plus muret rrethuese për të bërë edhe një unifikim. Pra ne duam që ië përfshujmë në projektin që kemi miratuar më parë edhe pjesën e unifikimit të mureve rrethuese si dhe atyre 3-4 objekteve që kanë mbetur tu bëjmë edhe atyre nje suvatim dhe një lyerje fasade dhe e gjithë ajo rrugë të marrë pamjen sikurse janë bërë edhe rrugët e tjera. Nuk kemi bërë ndonjë studim se sa mund të shtohet vlera e projektit, por duke u bërë me ndërmarrjen e bashkisë, besoj se kostot do të jenë në minimumin e mundshëm. Por thjesht ta shtojmë si zë në projekt, që edhe ndërmarrja të bëjë pjesën e justifikimit të shpenzimit që do të kryejë. Më saktë është një shtesë në projektin e mëparshëm. Mbas kësaj do të mbyllim pastaj edhe pjesën e ndriçimit publik që do të jetë një ndriçim dekorativ i gjithi. Kemi pasur një bashkëpunim me OSSHE-në dhe të gjitha linja elektrike i keni kaluar nëntokësore. Gradualisht po hiqen edhe shtyllat e tensionit. Edhe kabllorët janë sistemuar të gjithë nën tokë.Do të pajiset pastaj edhe me sinjalistikën rrugore, prandaj e kemi lënë edhe atë segmentin e parë që të mbyllet edhe pjesa e sinjalistikës qoftë horizintale qoftë vertikale. Jemi duke parë mundësinë edhe të dy semaforëve, për vendosjen e të cilëve kemi ngritur një grup pune dhe po bëjmë një studim dhe dëgjesa publike dhe në përfundim do ta sjellim projektin përfundimtarë në këshill për miratim.

Z.Ilia Fili

Zoti kryetar, besoj se, si gjithë të tjerët që janë ketu në sallë, kemi ardhur tashmë shpesh herë nga rruga nga Spitali Memorial këtu në Fier, kemi hyrë në një rrugë që na pëlqen të ecim në atë rrugën e re dhe sa kalojmë hekurudhën biem në një fushë të bardhë. Rrugë e përfunduar pa asnjë lloj vijëzimi. E dyta, unë rradhën e kaluar ju bëra një propozim dy nënkryetarëve. Na mbani diçka nga pagesat tona dhe krijoni një fond për një bojë të bardhë për të vijëzuar rrugët e qytetit. Ka muaj që e ngre këtë problem, sepse unë jam vetë drejtues mjeti dhe kuptoj se çfarë rëndësie kanë ato vijat e bardha në rrugë, dhe vazhdimisht heshtim e heshtim. Kështu që ta keni parasysh këtë projekt.

Z.Armando Subashi

Unë sapo e shpjegova. Ky studim që jemi duke ndërmarrë, do të parashikojë edhe shumë elementë shtesë të sinjalistikës që sot nuk i kemi në qytet, ku patjetër do të përfshihen edhe këto që sapo thatë ju. Nuk është kaq e thjeshtë kjo që thoni ju, se edhe për atë bojën e bardhë ka disa kategori që nga ajo më e lira që duhet ta vijëzosh rrugën çdo muaj, deri tek ajo termoplastikja, me të cilën kemi bërë edhe rrugët e tjera të qytetit, e cila reziston për vite me rradhë. Duket pak investim i shtenjtë në momentin e parë por është më jetëgjatë.

Z.Endri Jaupaj

Kryetar ndërkohë që shpjegojmë teknikalitetet. një i moshuar sot ndërroi jetë në një kryqëzim, tek Zogu i zi. Kështu që bojë e bardhë e thjeshtë apo termoplastike, mjaftontë vijëzohen. Kaluam edhe semaforët edhe kamerat, të cilat akoma nuk i kemi, prandaj jemi qytet apo jemi ndonjë provoncë e humbur në Kabul. Keni 10 minuta që po shpjegoni teknikalitet këtu. Është e pamundur, të lutem na i kurse këtë. Hidhi çfarëdo lloj boje të duash, por vetëm vijëzoi, sepse njerëzit po humbin jetën.

Z.Armando Subashi

Rasti që solle nuk ka të bëjë me këtë që po flasim. Ne le ti bëjmë edhe çdo një metër vizat e bardha. ai që e ndan mëndjen që të iki në mes të qytetit me 80,90 apo me 100 km në orë, do ta bëjë aksidentin. Nuk është se ndodhi aksidenti atje për mungesë të sinjalistikës. Sepse sikur fare sinjalistikë të mos kesh në qytet, ka një nen që është bazë në kodin rrugor dhe që secili e di, në qendrat e banuara shpejtësia maksimale është 30 km/orë, kaq. Po respektove këtë ,sikur asgjë fare të mos ketë në qytet, nuk ndodh aksidenti.

Z. Fatbardha Merkaj

E hedhim për miratim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 40 vota

Kundra 1 votë

Abstenim s'ka

Një votë kundër, të tjerat pro, miratohet.

Pika tetë e rendit të ditës

Projektvendim "Për miratimin në parim të dhënies me qira të pasurisë se llojit "ndërtesë", me sipërfaqje 345 m², përfituar mbi bazën e vendimit nr. 7 dt. 13.01.2021 "*Për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit* " ndodhur në pasurine Nr.27/1, zk. 1414, fshati Çlirim Njësia Administrative Qendër, pronë e Bashkisë Fier".

1

Z. Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga administrata ?

Z.Arbion Behari

Përshëndetje ! Materiali që ju kemi paraqitur bëjë me miratimin në parim të dhënies me qira të pasurisë se llojit "ndërtesë", me sipërfaqje 345 m², perfituar mbi bazën e vendimit nr. 7 dt. 13.01.2021 "*Për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit* " ndodhur në pasurine Nr.27/1, zk. 1414 fshati Çlirim Njësia Administrative Qendër, pronë e Bashkisë Fier". Duke qënë se si aset I bashkisë dhënia me qira e saj do të sillte shtimin e të ardhurave për bashkinë, ruajten e objektit nga degradimi, përmisin e objektit nga investimi I pritshëm që mund të bëhet nga subjektet përkatëse që mund ta marrin me qira këtë objekt. Bazuar në procedurat ligjore përkatëse propozojmë dhënien me qira të kësaj pasurie. Detajet e tjera I keni në materialet e paraqitura dhe të dërguara elektronikisht nga sekretari i këshillit.

Z.Armando Subashi

Në këtë objekt është bërë një investim në bazën e një projekti që ne kemi fituar përpara disa viteve me disa partner Italian me Murialdon me Engim etj. Është bërë një godinë, është pajisur me pajisjet e nevojshme, ku sipas projektit do të kryhej përpunimi I produkteve bujqësore, duke filluar nga komposto, reçelera, salcë etj, duke marrë produktet bujqësore nga fermerët e zonës, duke I përpunuar dhe pastaj produktet e gatshme duke I nxjerrë në treg. Funksionoi disa muaj, sepse ishte brenda vlerës së projektit, u punësuan disa njerëz atje që punuan, Prapë me lekët e projektit bliheshin produkte fruta perime nga zona aty, përpunoheshin dhe ambalazhoheshin në kavanoza me etiketë, kemi miratuar madje edhe logon Shporta Myzeqare, që dilin me etiketë ato vazot me reçel e kështu me rradhë. Por erdhi një ditë që projekti mbaroi dhe nuk u financua më. Tani jemi përpara dilemës që ne si bashki të miratojmë një buxhet atje, të punësojmë disa njerëz të cilët do të kryejnë të gjithë procesin dhe në finale nuk bëhet fjalë të fitojë bashkia por që I gjithë ky aktivitet të mbijetojë duhet të dalë me një fitim qoftë edhe minimal. Është një aktivitet I mirëfilltë tregtar që për mua si kryetar bashkie është I pamundur të kryhet nga ana jonë. Atëherë le të shikojmë mundësinë për ta dhënë me gira, kemi në bashkinë tonë shumë biznese që përpunojnë produktet bujqësore, objekti deri diku është I pajisur me pajisje që kanë ardhur nga italia për të përpunuar këto produktet bujqësore, dhe le ta tentojmë sepse ndoshta mund të ketë interes ta marrë dikush me qira. Shumë mirë do të ishte të kishte sukses sepse do të ishte ndihmë edhe për një pjesë të atyre produkteve fruta-perime të zonës, por edhe për produktet që mund të prodhojë dhë pastaj ne mund të lidhemi prapë që të marrim një vendim për ta ndihmuar dhe stimukuar që fjala vjen produktet e gatshme kundrejt një vlere të caktuar mund ti marrim dhe ti përdorim ne për pjesën tonë të kopshteve fjala vjen, sepse ne kemi guzhinë sot dhe gatuajmë për çerdhet, kopshtet, gatuajmë për konviktin e shkollës bujqësore për aq nxënës sa janë atje, dhe mundet që ti krijojmë edhe një lloj lehtësie që këto produkte nëse janë brenda cilësisë së caktuar ti marrim dhe të furnizojmë objektet e sipërcituara në vend që ti blejmë diku tjetër. Kjo mund ti përkasë një faze tjetër por e rëndësishme është që ta tentojmë ta japim me gira sipas vlerave gë përcakton VKM-ja, pasi ka një të tillë që përcaktontarifat e dhënies me gira. Objekti do të dalë në ankand të hapur nëse afrohet dikush që të na japë dicka më shumë, pse jo. Nëse nuk afrohet dikush, atëherë këtu do të jemi bashkarisht prapë dhe shikojmë mundësinë se çfarë mund të bëjmë. Kjo është e thënë me fjalë më të kuptueshme, pr ana ka mbetur objekti me gjithë pajisjet, le të vendosim së bashku se çfarë do të bëjmë.

Z. Fatbardha Merkaj

N

E hedhim në votim. Kush është pro?

• • •

Pro 40 vota

Kundra s'ka

Abstenim 1 votë

Një abstenim, të tjerat pro, miratohet.

Pika e nëntë e rendit të ditës

Projektvendim "Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Xhoxhi Shqepa, lagjia "29 Nëntori", Njësia Administrative nr.3, i dëmtuar nga zjarri i datës 22.04.2025."

Z. Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga ana e administratës ?

Z.Armando Subashi

Kam një propozim që të gjitha këto pikat që kanë të bënjë me ndihmat financiare të kalohen bashkë për të mos humbur kohë për shkak të natyrës së përbashkët që ato kanë. Pra Xhoxhit i ka rënë zjarr, tek Vlashi janë për tu paguar shpenzimet e varrimit, tek Andrea Zarka ku qëndron problemi ?

Z. Elvi Daka

Ai është pak rast specific kryetar. Jo vetëm që i takon por i takon edhe pak më shumë se vlera e përcaktuar këtu në projektvendim. Në bazë të VKM-së edhe si përfaqësues i zonës ku ai jeton. por edhe si kryetar I komisionit të çështjeve sociale, mendojë se duhet ti jepet tavani, pasi përveç gjëndjes së rrënuar të shtëpisë në të cilën jeton, ka edhe 2 fëmijë me spektër autizmi dhe prapambetje mendore.

Z. Armando Subashi

E kemi hapsirën ligjore për ta bërë 300 000 lekë të reja ? Ok. Jemi të gjithë dakort për 300 000 lekë të reja ? Ok. Kemi edhe një rast këtu tek pikat shtesë që ti trajtojmë si bllok këto ndihmat financiare. Rasti Elvis Tare. Është bërë ndonjë vlerësim këtu, sa lekë do të marrë apo në bazë të orendive të dëmtuara ?

Z. Nasip Bani

Dokumentacioni është i plotë dhe i është paraqitur këshillrarëve edhe në mbledhjen e komisionit përkatës.

Z.Kreshnik Dapi

Në cilësinë e kryetarit të komisionit, mund t'ju them se është mbledhur komisioni për te treja rastet si per pikën 9. 11 dhe për pikën e parë shtesë të rendit të ditës, pra për zotin Elvis Tare.Vlen të përgëzohet administrata, sidomos për rastin Andre Zaka, dhe unë pasi kam biseduar edhe me përfaqësues të bashkisë, ftojë të nxisim këshilltarët, duke marrë shkas edhe nga ky rast këtu, që në komunitetet e tyre, raste të tilla ti gjenë dhe ti përcjëllin pranë këshillit dhe admistatës së bashkisë, sepse brenda mundësive ekonomiko-ligjore që ka bashkia, ne do të mundohemi ti trajtojmë të gjithë njerëzit që janë me nevoja të tilla si ky rast. Sa për procedurën, të tre rastet komisioni i kaloi me shumicë votash. Mirë do të ishte, që ndihma të ishte diku edhe më e lartë, por aq na lejon ne edhe ligji.

1 ,

Z. Armando Subashi

Meqënëse jemi këtu, kam edhe diçka tjetër, sepse kjo që do të them lidhet pikërisht me këto që sapo diskutuam. Tek shtesat, kemi pikën e dytë shtesë për miratimin e subvencionit të qirasë.

Z.Esmeralda Kapllanaj

Është rasti i një zonje, i zonjës Xhensilda Mija kryefamiljare, e divorcuar me katër fëmijë të mitur, banuese në qytet, e cila kërkon të përfitojë bonusin e qirasë. Dhe meqënëse janë 5 anëtarë, i takon apartament me strukturë 2+1.

Z.Armando Subashi

Ok. Referojuni VKM përkatëse për vlerën e bonusit të qirasë për rastin përkatës. Në rregull i quajmë të trajtuara këto pikat që kanë të bëjnë me ndihmat financiare dhe me këtë subvencionin. Tek pikat shtesë meqënëse jemi këtu, kemi pikën tre, e cila ka të bëjë më shtyrjen e afatit të taksave dhe tarifave vendore. Kur miratuam paketën fiskale, kemi përcaktuar atje që afati për pagesën e tyre është fundi i muajit prill apo jo ? Realisht gjatë kësaj kohe, edhe për shkak të situatave, edhe për shkak se ka pasur momente që edhe ky sistemi i taksave që kemi ne këtu në bashki ka pasur probleme, për shkak të operatorit qendror që është në Tiranë, që është Infosofti, i cili ka ditë që edhe nuk ka punuar. Përpos kësaj, edhe një numër biznesesh na kanë kërkuar shtyrjen, kështu qe ne propozojmë që nga 30 prilli afati të shkojë në 30 qershor. Dhe llogaritja e kamatvonesës të fillojë pas kësaj date. Sepse këtu është i gjithë problemi, se nëse nuk i paguan brenda afatit, fillon llogaritet kamatvonesa, e cila është në mos gabojë 0.06% për çdo ditë vonesë, sikurse e përcakton ligji. Ky është propozimimi ynë për këtë pikë. Për pikën tjetër shtesë, atë që ka të bëjë më nivelin e pagesës për vrojtuesit e plazhit. Këtë fundjavë fillojmë çeljen e sezonit turistik, është miratuar harta e përcaktimit për plazhet private dhe ato publike. Tek ato që janë plazhe private, subjektet që kanë bërë atë investimin, kanë lidhur kontatat me Agjensinë e Bregdetit dhe e kanë marrë përsipër vetë këtë pjesë. Detyrimi jonë është që në ato parcela që janë konsideruar si plazhe publike, veç të tjerave, ne duhet të garantojmë ato edhe me roje plazhi. Vjet kemi pasur dy dhe nuk mund ta përballonim dot. Sivjet edhe ata të dy ishin me mëdyshje, sepse këta duhet të jenë persona të liçensuar, dhe kuptohet i gjthë pretendimi ishte tek paga. Me 420 mijë lekë të vjetra në muaj, për një person që rri nga ora 8 e mëngjesit deri ne 8 të darkës, dhe të marrë atë pagesë, nuk është normale, duke pasur parasysh edhe rriskun e mbytjes së plazhistëve. Prandaj gjykuam që duhet bërë një rritje page për këta, me idenë që duhet ta stimulojmë si process për të ardhur edhe persona të tjerë më pas, të cilët mund të kenë interes për këto 2-3 muajt e verës. Dhe e vërteta është që ajo paga 420 mijë lekë të vjetra, është nga pagat më minimale që aplikohen sot në të gjithë systemin e pagave. Sa e keni propozuar nivelin e pagës tani?

Z.Eleni Gjikondaj

E kemi propozuar 80 000 pagën bruto dhe neton 68 000. Nuk përfitojnë orë shtesë pasi janë punonjës të përkohëshëm dhe nuk përfshihen në listëpagesa, por taton vetëm në tatim në burim në masën 15%. Me 11 orë punë, nga 1 qershori deri në 15 shtator pa asnjë ditë pushim, as të shtunë as të dielë.

Z.Armando Subashi

Sa merr një specialist i lartë në bashki ? 80 000 lekë apo jo ? Sikurse e shihni janë edhe disa proporcione që duhen ruajtur. Nuk mund të marrë një roje plazhi më shumë se një specialist i lartë në bashki.

Z.Kreshik Dapi



0

1

0

Kryetar kam nje mendim, sepse ajo me të vërtetë konsiderohet si punë apo si profesion, por në të vërtetë ajo është një detyrë. Edhe ata djem e vajza që do të dalin atje, më shumë si vullnetarë do të dalin. Dhe janë për tu përgëzuar, duke pasur parasysh edhe rriskun që ata kanë si për jetën e tyre, edhe të atyre që do të përpiqen të shpetojnë. Prandaj ne duhet të shikojmë edhe ndonjë hapsirë tjetër, sepse vërtetë gjëndja ekonomike e bashkisë mbase nuk na i lejon, por edhe ti lësh ata që të punojnë 12 orë në kushte ekstreme moti, sepse kënaqësia është për plazhistin, kurse ata janë në një gjëndje tjetër atje, në vapë në të nxhehtë, do të hyjnë edhe në det. Kështu që duhet mendur të gjendet diçka në bashkëpunim me ministrinë e financave apo atë të turizmit, për ti vlerësuar pak më shumë ata, nëse ka hapsira ligjore. Meqënëse e mora fjalën, kisha edhe diçka për pikën e tretë shtesë, për shtyrjen e taksave. Në rradhë të parë, është për tu përgëzuar kjo iniciativë e bashkisë. Ne kemi qenë këtu edhe në fund të vitit dhe bëmë pak debate edhe për paketën fiskale. Mua më vjen mirë që sivjet bashkia reflekton. Këtu tek arsyetimi, tek relatori, tek pika e parë, për mua nuk qëndron. Këtu thuhet "situate ekonomike e bizneseve nuk është e mirë, pasi po përballen me vështirësi". Për mua kjo nuk qëndron. Gjëndja ekonomike e Shqipërisë është positive, sipas të dhënave zyrtare. Këtu ka një detaj që duhet theksuar. Ky ishte vit elektoral. Një pjesë e mirë e jona këtu, ishim të përfshirë direkt ose indirekt, ndërkohë që merremi edhe me veprimtari private. Ato veprimtari kaluan në plan të dytë, duke lënë në plan të dytë edhe pagesat, punën etj, dhe mua më vjen mirë që bashkia këtë gjë e ka marrë parasysh, pavarsisht që nuk e thotë dot hapur. E dyta në lidhje me këtë problem. Para një muaji, në mos gabojë, qeveria qëndrore bëri një ligj shumë pozitiv që fali disa gjoba, kamatvonesa, nuk e di në jam i saktë dhe mendoj mos ai ligj prek edhe disa gjoba dhe kamatvonesa në nivel lokal dhe për këte është e nevojshme që ta shtyjmë afatin për në 30 shtator. Për mua, e drejtë nuk është që bashkia të marrë një shërbim të pa ofruar, parapagim. Ta shpjegojë. Atëherë çdo vit ne i kërkojmë bizneseve që taksat të paguhen siç thamë deri në 30 prill. Gjatë periudhës tjetër të vitit, ky biznes mund të mbyllet, administratorët e tij mund të pësojnë fatkeqësi, mund të largohen nga qyteti. Si veprohet në këto raste ? Mua nuk më duket korrekte. Ka qenë më mirë pagesa me 3 mujorë. Dhe më e lehtë ekonomikisht për tu përballuar, ishte dikur. Faleminderit !

Z.Armando Subashi

Edhe diçka tjetër. Tek pika e fundit shtesë, sepse jemi pikërisht këtu. Ju e dini që ne kemi disa vite që që familjarëve, qoftë taksën e pasurisë për shtëpinë apo çfarëdo pasurie tjetër, qoftë edhe tarifën, atje ku shkon fatura e ujit, sepse atje ku nuk shkon ka mënyra të tjera, e vjelim nëpërmjet ujësjellësit. Ky është në rolin e agjentit tatimor, për çdo të ardhur që mbledh për bashkinë merr 2%, pjesën e tij. Kemi një kontratë 5 vjeçare. E vërteta është që ai i ka mbledhur, sepse çdo muaj bëhet rakordimi midis përfaqësuesit të bashkisë dhe atij të ujësjellësit me bankat, thesarin e kështu me rradhë. I ka mbledhur këto lekë, sepse ai që shkon për të paguar ujin paguan edhe detyrimet e bashkisë dhe realisht një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë derdhur në bashki. Pra janë lekë që janë mbledhur për ne dhe ne nuk na janë derdhur. Kemi pasur korrespondeca të vazhdueshme. Herë pas here bëhet ndonjë likujdim. Realisht gjithë 2025 pothuajse është korrekt, por janë të gjitha shuma të akumuluara nga 2024 dhe 2023. Është gjetur si mangësi edhe në projek-raportin e KLSH-së, ku thuhet që bashkia duhet të bëjë të gjithë përpjekjet deri në hapjen e procedurave gjyqësore, për të bërë të mundur kthimin e kësaj shume nga ujësjellësi. Në fund të fundit, janë lekët tona. Edhe 2-3 javët e fundit kemi pasur korrespondenca me ata, nuk ka asnjë reagim, kështu që tani le të hapim procesin gjyqësor dhe le ta ndajë gjykata këtë punë, jo vetëm për principalin, por edhe për llogaritjen e kamatvonesave, sepse marrëveshja që kemi me ta parashikon edhe ato, për ditët vonesë që ata kanë në likujdimin e këtij detyrimi. Kështu që thjesht i jepni leje ekzekutivit sot që të fillojë procedurën gjyqësore. Ky është thelbi i kësaj pike shtesë në rendin e ditës. Meqënëse e mora fjalën i kalova njëherësh të gjitha. Tani gjithësecili prej jush është i lirë të diskutojë dhë më pas të votohen një nga një. Faleminderit !

~

V

1 .

Z. Ilia Fili

Më falni. Nuk po diskutojë për pikat e tjera por duhet të ndalem vetëm tek ajo pika që ka të bëjë më shtyrjen e afatit të taksvave. Unë personalisht jam kundra, pasi muk gjejë asnjë lloj justifikimi që të gjithë ata që kanë detyrime, nuk i kanë shlyer brenda afatit që përcakton lligji dhe VKB përkatëse. Dhe do ta konsideroja këtë dhe po e them publikisht këtu, si një dhuratë që ju po i bëni këtyre subjekteve pas fitores. Nëse ka një vendim kryetar, nuk ka asnjë lloj justifikimi për mospagesën e taksave nga ana e tyre.

Z. Arben Çuko

Ka edhe probleme biznesi inxhinier, nuk i kanë të gjithë gjërat tel.

Znj. Suzana Numani

Nuk kanë punuar ndonjëherë në biznes këta që flasin kështu, kanë punuar vetëm në shtet, pasi ai që ka biznes e ndjen këtë. Nuk kam dashur të flasë, por tani ndjehem e detyruar të flasë. Sepse nuk është kaq e thjeshtë me biznesin.

Z. Armando Subashi

Këto nuk janë zgjedhje lokale dhe nuk ka lidhje bashkia dhe taksat dhe tarifat e saj me këto zgjedhje. Zana ka biznes, Beni ka biznes, këta janë të dy opozitarë, këtyre po u bëjë dhuratë unë pas fitores ?

Znj. Fatbardha Merkaj

Atëherë le ti hedhim një e nga një në votim pikat e mbetura. Përsa i takon pikës 9 të rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim ska

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika dhjetë e rendit të ditës

Projektvendim "Për miratimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit të z.Vlashi Turtulli"

Znj.Fatbardha Merkaj

Meqënëse u trajtua më lart kalojmë në votim. Kush është pro?

Pro 41

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës

Projektvendim "Për dhënie ndihme të menjëhershme për z.Andrea Zaka"

18

 \vee

Znj.Fatbardha Merkaj

Meqënëse u trajtua më lart kalojmë në votim. Kush është pro?

Z. Arnando Çupa

Krytare vetëm të lutem përmënde që vlera do të shkojë nga vlera e propozuar nga administrata prej 200 000 lekë në vlerën e propozuar këtu në 300 000 lekë.

Znj. Fatbardha Merkaj

Përsa i përket zotit Andre Zaka, vlera nga propozimi i administratës prej 200 000 lekë do të bëhet 300 000 lekë. Kush është pro ?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro. Kalojmë në miratimin e pikave shtesë të rendit të ditës dhe pikën 12 e lëmë për në fund meqënëse është informacion dhe nuk ka nevojë për votim.

Pika e parë shtesë e rendit të dites

Projektvendim "Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Ervis Tare, lagjia "Konferenca e Pezës", Njësia Administrative nr.2, i dëmtuar nga plasja e bombolës së gazit në banesën e tij në datën 11.05.2025."

Znj. Fatbardha Merkaj

Meqënëse u trajtua më lart kalojmë në votim. Kush është pro?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e dytë shtesë në rendin e ditës

Projektvendim "Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjen e pastrehë, që kërkon të përfitojë nga subvencionimi i qirasë në tregun e lirë dhe nuk ka të ardhura për të përballuar vlerën e qirasë"

Znj. Fatbardha Merkaj

Meqënëse edhe këtë pikë e trajtuam më lart, mendoj të kalojmë në votim. Kush është pro?

1

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

 \frown

1

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e tretë shtesë në rendin e ditës

Projektvendim "Për shtyrjen e afatit të pagesës së taksave vendore për subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Fier për Vitin 2025 "

Znj. Fatbardha Merkaj

Meqënëse edhe këtë pikë e diskutuam më lart kalojmë në votim. Kush është pro?

Pro 40 vota

Kundra 1 votë

Absenim s'ka

Një votë kundër, të tjerat pro miratohet.

Pika e katërt shtesë në rendin e ditës

Projekvendim "Për miratimin e nivelit të pagave të vrojtuesve të plazhit"

Znj.Fatbardha Merkaj

Meqënëse edhe këtë pikë e diskutuam më lart kalojmë në votim. Kush është pro ?

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Absenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e pestë e rendit të ditës

Projektvendim "Për fillimin e procedurave gjyqësore për detyrimin e Shoqërisë së UKR, si Agjent Tatimor ndaj Bashkisë Fier"

Znj.Fatbardha Merkaj

Meqënëse edhe këtë pikë e diskutuam më lart kalojmë në votim. Kush është pro?

0

Pro 41 vota

Kundra s'ka

Absenim s'ka

V

Miratohet me të gjitha votat pro. Kemi edhe pikën 12 të rendit të ditës të cilën meqënëse është informacion dhe nuk ka nevojë për votim, e lamë për ta diskutuar tani në fund të mbledhjes.

Pika dymbëdhjetë e rendit të ditës

Informacion "Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të IV mujorit të vitit 2025 të Bashkisë Fier"

V

Znj. Fatbardha Merkaj

Kush do të flasë shumë shkutimisht për këtë pikë nga ana e administratës ?

Z. Eleni Gjikondaj

Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2025 shkon në vlerën prej 3,431,771 mijë lekë. Plan i katërmujorit të parë të vitit 2025 është në vlerën prej 1,703,765 mijë lekë. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të 4- Mujorit te parë të vitit 2025, nga te gjitha burimet e financimit, janë realizuar në vleren 746,766 mije lekë me një nivel realizimi prej 44 %. Për më shumë konsultoni materialin që ju kemi dërguar përmës sekretariatit në mënyrë elektronike. Faleminderit !

Znj. Fatbrdha Merkaj

Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur. Ju falenderojë të gjithëve për pjesëmarrjen !

Ky procesverbal ka 21 (njëzet e një) faqe dhe mbahet në tre koje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Cupa

Zv. Kryetar i Këshillit Fatbardha Merkaj ASHKI

Tropi Jula Arben ala. Guis SEXT

vestuile Aspi